



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2023:170876  
Datë: 28.02.2024  
Numri i dokumentit: 05385188

KPPP.nr.1255/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit Instituti i Mjekësisë së Punës në Kastriot-Obiliq, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.D. avokat nga Prishtina, kundër debitorit Trepça Mitrovicë-Njësia Biznesore Minierat me flotacion Kishnicë dhe Artanë me NRF: 600141543, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.258/23 të datës 06.07.2023, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Afet Mjeku, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 20.02.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. REFUZOHET NË TËRËSI** i pabazuar prapësimi i debitorit Trepça Mitrovicë-Njësia Biznesore Minierat me flotacion Kishnicë dhe Artanë, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.258/23 të datës 06.07.2023, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Afet Mjeku, dhe i njëjti Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.

**A r s y e t i m**

Përmbartuesi Privat, me Urdhrin Përmbartimor P.nr.258/23 të datës 06.07.2023, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, e ka caktuar përmbartimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm–faturës nr.447/22-E të datës 01.11.2022, me të cilin ka urdhëruar që në afat prej 7 ditësh nga dita e këtij urdhri, t'i paguajë kreditorit borxhin në shumën prej 41,200.00 Euro, me

kamatë 8% nga dita kur ka qenë i obliguar të paguaj obligimin e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

Kundër urdhrimit të Përmbartuesit Privat, debitori ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor, me arsyetimin se dokumentet në bazë të të cilave është marr i njëjti, nuk janë të përshtatshme për përmbartim, sepse në këto fatura nuk është cekur koha e përmbartjes së detyrimit, ashtu siç parashihet me nenin 27 par.1 të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që të anulohet urdhri për përmbartim P.nr.258/23 i datës 06.07.2023.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se është i pabazuar prapësimi i debitorit, me arsyetimin se përmbartja e prapësimit nuk përmbart asnjërin nga kushtet sipas nenit 71 të LPP-së, dhe se debitori në prapësimin e tij nuk e kundërshton borxhin dhe i njëjti faturat i ka pranuar dhe nënshkruar. Ka theksuar se debitori prapësimin e ka paraqitur vetëm sa për ta zvarritur procedurën e përmbartimit, duke i propozuar gjykatës që prapësimi të refuzohet si i pabazuar dhe urdhri për caktimin e përmbartimit të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, pretendimeve në përgjigje në prapësim të kreditorit, dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit monetar”*. Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në shkresat e lëndës është evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbartim dokumentin e besueshëm faturën nr.447/22-E të datës 01.11.2022, në origjinal dhe me të gjitha elementet përmbartësore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura nr.447/22-E e datës 01.11.2022, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, e njejtja është dorëzuar në origjinal dhe është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt ky i cili vërtetohet me nënshkrimin e debitorit.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1255/23, me datë 20.02.2024

Gj y q t a r i  
Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.